



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**  
**MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË**  
**SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008,” i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-108 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016”, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë .....2026, miratoi këtë:

**Draft - V E N D I M**  
**Për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të Komunës**

**Neni 1**

1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit fiskal 2025 nuk i ka shpenzuar mjetet e THV-së 2024 dhe 2025 andaj jemi të obliguar që të bëjm bartjen e tyre mjeteve në shumë prej = **746,566.82€**.

1.2. Mjetet e grumbulluara si të pa shpenzuar gjat vitit 2024/2025 që duhet bartur në vitin fiskal 2026 është shuma prej **746,566.82€** që janë të paraqitura në tabelën e poshtëshenur sipas njësive buxhetore dhe kategorive ekonomike.

**Tabela 1**

Programet/nënprogramet	Mallra dhe	Sherbime	Subvencio	Invstime Kapitale	TOTAL:
	Sherbime	Komunale	ne dhe Transfere		
Zyra e Kryetarit (16012)		-	1,104.78		<b>1,104.78</b>
Administrata (16312)	11,371.72				<b>11,371.72</b>
Shërbimet Publike dhe emrgjente (18012)	-	4,514.41	-	<b>296,654.01</b>	<b>301,168.42</b>
Buxhet dhe Financa(17512)	2,454.76	-	-	-	<b>2,454.76</b>
Shendeti primar- QKMF (73750)	40,000.00				<b>40,000.00</b>
Administrata e Arsimit (92060)	-	14,467.14	-	-	<b>14,467.14</b>
Shërbimet kulturore (85012)			60,000.00	-	<b>60,000.0</b>
Bujqësi dhe Zhvillim Rural (47012)				<b>316,000.00</b>	<b>316,000.00</b>
<b>TOTAL:</b>	<b>53,826.48</b>	<b>18,981.55</b>	<b>61,104.78</b>	<b>612,654.01</b>	<b>746,566.82</b>

**Lista e projekteve kalitale për bartje nga viti 2024 dhe 2025 që do të bartet në vitin fiskal 2026 për shpenzim**

**Tabela 2.**

Nr. Ren	EMRI I PROJEKTIT	FINANCIMI NGA BARTJA 2024/2025
1	57007 – Ndërtimi i urave Reqan, Reshtan dhe Bukosh	60,000.00
2	57000 - Instalimi dhe sanimi i ndriqimëve publike në fshatrat Savrovë,Doberdelan,Bukosh,Sopijë dhe Komunë	236,654.01
	<b>Gjithsej : Sherbimet Publike dhe Emergjente (18012)</b>	<b>296,654.01</b>
3	52616- Projekt me Bashkëfinancim	316,000.00
	<b>Gjithsej :Bujqësi dhe Zhvillim Rural (47012)</b>	<b>316,000.00</b>
	<b>TOTAL Komunal :</b>	<b>612,654.01 €</b>

### Arsyetim

- Shuma prej **746,566.82€** duhet të bartet në programin e SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim dhe shpenzim,në këto programe buxhetore dhe projekte kapitale si pjesë a pa shpenzuar nga THV 2024 dhe 2025.
  - Mjetet e pa shpenzuara gjatë periudhave të cilat do shpërndahen sipas vendimit të Kuvendit të Komunës në këto kategori ekonomike:
  - Në **“Mallra dhe sherbime”** shuma prej **53,826.48€** sipas drejtorive konform tabelës 1 ;
  - Në **“Sherbime komunale “** shuma prej **18,981.55 €** sipas drejtorive konform tabelës 1 ;
  - Në **“Subvencione dhe transfere”** shuma prej **61,104.78€** sipas drejtorive konform tabelës 1 ;
  - **Në kategorinë e “Investimeve kapitale”** shuma prej **612,654.01€** sipas drejtorive konform tabelës 1.
- Për kategorit ekonomike **“Mallta dhe sherbime,”**shuma prej **53,826.48€** të ndara në njësit buxhetore janë obligime të mbetura pa u paguar si pasojë e Vendimeve përmbarimore –të gjykatave në shumë prej **49,384.65€ te Shëndeti Primar-QKMF(73750)** për kompenzimin e pagave për punëtorët arsimor si obligim i ministrive të linjes e në ngarkesë të buxhetit komunal kurse pjesa tjetër e kësaj ketegorie janë mjete të mbetura e të pashpenzuara që duhet bartur për shpenzim në vitn fiskal 2026.
  - Kategoria e **“shpenzimeve komunale”** shuma prej **18,981,55 €** të ndara në njësit buxhetore janë obligime të cilat duhet paguar pasi që Vendimet përmbarimore –të gjykatave kanë prekur edhe këtë kategori ekonomike.
  - Kategoria **“Subvencione dhe transfere”** në shumë prej **61,104.78€** pjesë e mbetur që nuk do të ndryshojm strukturën e shpenzimeve konform ligjit të buxhetit për vitin 2025 ku nga drejtoria e kultures janë ekzekutuar vendime gjyqësore subvencione në shumë prej **53,808.59€** e që kanë mbetur obligime të papaguara sipas RVF 2025.
  - Kategoria e **“Investimeve Kapitale”** në shumë prej **612,654.01€** ,nga këto :
    1. Nga projekti “ Instalimi dhe sanimi i ndriqimëve publike në fshatrat Savrovë, Doberdelan, Bukosh, Sopijë dhe Komunë “ janë në pritje vendimet gjyqësore për ekzekutim në shumë prej **242,016.12 €** e të cilat mjete duhet kompezuar nga kjo bartje e mjeteve pasi që kemi obligime kontraktuale ndaj operatorëve ekonomik.
    2. Nga projekti “Ndërtimi i urave Reqan,Reshtan,Bukosh”projektit në fjalë do të shtohet edhe shuma prej **60,000.00€** nga pjesa e realizuar e të hyrave nga denimet e trafikut,gjykatave dhe pyjeve si shtesë për të realizuar projektin e palanifikuar në fjalë .
    3. Nga “Projekti me bashkëfinancim “ sipas vendimeve gjyqësore janë shpenzuar shuma prej **266,235.14€,**e cila shumë duhet të kompenzohet në shumë prej **316,000.00€** si obligime të mbetura dhe pjesa tjetër obligime kontraktuale për vitin 2026.
  - Të gjitha shumatat e cekura më lartë sipas kategorive ekonomike dhe njësiteve buxhetore nuk e prishin

strukturen e shpenzimeve sipas ligjit të buxhetit Nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore të Buxhetit të RKS për vitin 2026.

- Neni 8 pika 6 dhe 7 e këtij ligji thuhet se bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2026 sipas autorizimeve të LMFPP-së .

### **Neni 2**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

### **Neni 3**

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendim i njëjti do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake pjesa e pa shpenzuar gjat vitit fiskal 2024 dhe 2025, e të cilat do të barten alokohen në SIMFK dhe shpenzohen në vitin fiskal 2026.

## **KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË**

**01-Nr-**\_\_\_\_\_

**Me datë**\_\_\_\_\_

**Kryesuesi i Kuvendit**

\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**